

**URIMI PËR RAMUSH HARADINAJN**

Kryebashkiaku Mziu: Më në fund drejtësia triumfoi



FAQE 4

**PASKUQAN**

Së shpejti nis ndërtimi i rrugës "Halim Xhelo"



FAQE 3

**SHËRBIME**

Punë intensive e Drejtorisë së Urbanistikës për realizimin e projekteve në infrastrukturën e qytetit



FAQE 6

**SPORT**

Federata Shqiptare e Basketbollit nderon me "Certifikatë Mirënjohjeje" kryebashkiakun Xhelal Mziu



FAQE 8



Gazetë e Bashkisë Kamëz

# KAMZA

E përdyjavshme  
Nr. 198 prill 2017  
Çmimi 20 lekë  
drmediakamez@gmail.com  
www.kamza.gov.al

**Inspektimi i punimeve në rrugën "Banka Botërore"**

## Kryebashkiaku Mziu: Të gjitha investimet në Kamëz, të financuara vetëm nga Bashkia

FAQE 2

**Rivitalizimi në Qendër-Babrru, Mziu: Do ta bëjmë një qytet më të këndshëm**

Faqe 3

**Kryebashkiaku Mziu, në takim me anëtarin e Komisionit për Çështjet e BE-së në Bundestagun Gjerman, Thorsten Frei**

Faqe 4

**Gënjeu për legalizimet falas në 2013, Rama rikthehet në Kamëz, aty ku mashtroi shqiptarët**

Faqe 5

**Drejtorja e Arsimit në Bashkinë Kamëz, zgjidhje të menjëhershme problematikave në kopshtet dhe shkollat e qytetit**

Faqe 6



**"Kamza Karate Open 2017", turneu ndërkombëtar në palestrën e Bathores me pjesëmarrjen e sportistëve nga 5 shtete**

FAQE 8



**NË BRENDESI**

Ndërmarrja e Ujësjetës-Kanalizimeve rrit kapacitetet e shërbimeve në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz

FAQE 6

Lagjes nr. 2 Kamëz i shtohet një tjetër investim, kanalizimet në rrugën "Fatmirësia"

FAQE 2

Policia Bashkiake vijon punën për lirimin e hapësirave publike dhe garantimin e investimeve në Bashkinë Kamëz

FAQE 6

24 prilli si 18 shkurti, "Deja Vu" e dytë e Republikës së Re, protestë paqësore me jehonë ndërkombëtare

FAQE 7

Presidenti Bujar Nishani dekoron trajnerin e Kamza Basket, Adem Muhametaj, me titullin "Mjeshtër i Madh"

FAQE 8



## Kryebashkiaku Mziu inspekton punimet në rrugën “Banka Botërore”, një investim i dobishëm për mijëra banorë në Bathore dhe Bulçesh



Të gjitha investimet që po realizohen në Kamëz dhe Paskuqan, janë të financuara vetëm nga buxheti i Bashkisë. Kështu është shprehur kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, gjatë inspektimit të punimeve që po kryhen në rrugën “Banka Botërore” në Bathore e Bulçesh.

Ashtu siç ka ndodhur për katër vite me radhë, Kryeministri dhe qeveria e tij nuk kanë dhënë asnjë qindarkë për banorët e qytetit të gjashtë në vend. Për t’iu kundërvënë këtij diskriminimi, Bashkia Kamëz ka shfrytëzuar të gjitha burimet

e veta për të financuar investimet publike në tërë territorin e saj. Segmenti ku po investohet është i gjatë 475 metra linearë, gjerësi 6 ml, si dhe trotuare në të dyja anët me nga 1 metër.

Gjithashtu, rruga do të ketë edhe ndriçim dhe gjelbërim. Ndërtimi i rrugës “Banka Botërore” në këto dy lagje është mjaft i rëndësishëm për banorët, pasi kjo rrugë është një nyje e rëndësishme lidhëse ndërmjet këtyre dy lagjeve, si dhe pjesëve të tjera të qytetit. Për banorët e Bathores

dhe Bulçeshit ndërtimi i kësaj rruge ka një impakt të jashtëzakonshëm në jetën e tyre të përditshme, për shkak të krijimit të lehtësive në qarkullim, si të këmbësorëve ashtu edhe të automjeteve. Një vlerë më shumë kjo rrugë merr, pasi do të bëhet shkas për zhvillimin e

biznesit dhe rritjen e numrit të të punësuarve. Fondet për realizimin e projektit të hartuar nga specialistët e Urbanistikës janë përballuar nga vetë Bashkia, duke qenë se qeveria dhe ministritë përkatëse nuk kanë denjuar asnjëherë në katër vite të akordojnë fonde për qytetarët e Kamzës.

### Të gjitha investimet në Kamëz, të financuara vetëm nga Bashkia

Investimet në infrastrukturë, kanalizime, ujësjellës, mjedis dhe në çdo fushë tjetër në Kamëz janë vetëm nga buxheti i Bashkisë. Që në fillim të këtij viti kalendarik është vënë në funksion zbatimi i buxhetit të kësaj Bashkie, duke e përqendruar vëmendjen kryesore në investime dhe shërbime. Kështu, 60% e këtij buxheti ishte planifikuar për t’u kthyer në investime për të përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën e qytetit si dhe për të përmirësuar ndjeshëm mjedisin ku qytetarët e Kamzës jetojnë. Duhet përmendur që investimi themelor i kësaj Bashkie është bulevardi “Demokracia” në Njësinë Administrative Paskuqan, një segment me gjatësi rreth 7 km. Ky investim është kryer me urbanizim të plotë nga stafi i Bashkisë Kamëz dhe buxheti i derdhur në këtë investim është i tëri nga Bashkia Kamëz. Jo vetëm ky investim që po vazhdon të realizohet, por edhe të gjitha investimet e tjera që realizohen në territorin e Kamzës, janë të gjitha nga buxheti i Bashkisë.

### Mes shumë investimeve që do të realizohen në vitin 2017, edhe ndërtimi i rrugës “Milano” në lagjen 1 Kamëz



Një tjetër investim i dobishëm për një pjesë të konsiderueshme të komunitetit të banorëve të Kamzës do të jetë realizimi i projektit për ndërtimin e rrugës “Milano”.

Kjo rrugë, e cila ndodhet në lagjen nr. 1 Kamëz, është e gjatë 345 ml dhe e gjerë 4 ml. Pas realizimit të investimit, kjo rrugë do të kthehet në një segment me parametra bashkëkohorë.

Duke pasur parasysh kërkesat dhe nevojat e mijëra qytetarëve të zonës, në prioritetet e Bashkisë Kamëz për vitin 2017 është edhe ndërtimi i kësaj rruge, e cila ndikon si në aspektin social ashtu edhe në atë ekonomik.

Kjo, për vetë faktin se realizimi i këtij investimi të rëndësishëm do të ndikojë në shtimin e numrit të bizneseve dhe për rrjedhojë edhe të të punësuarve.

Rruga “Milano” bën lidhjen e banorëve të zonës me Bulevardin Blu dhe rrugën “OSBE”, duke qenë kështu një nyje lidhëse e rëndësishme.

### Vijojnë investimet e Bashkisë me ndërtimin e rrugës “Peshkopia” në lagjen 3 Bathore



Një tjetër rrugë me parametra bashkëkohorë do t’i shtohet qytetit të Kamzës në vitin 2017.

Bashkia ka parashikuar që të ndërtojë këtë vit rrugën “Peshkopia”, e cila ndodhet në lagjen nr. 3 Bathore.

Rruga “Peshkopia” është një segment që lidh banorët e zonës me rrugën “Besëlidhja”, rrugë kjo që del te rruga kryesore “Demokracia”. Projekti i këtij segmenti rrugor, ku do të investohet, ka gjatësi 152 ml e gjerësi prej 4 m dhe me bankinë nga 0.5 m nga të dyja anët. Rruga “Peshkopia” ka një rëndësi të veçantë për zonën, pasi jep impakt mjaft pozitiv për banorët e saj, duke qenë se ndodhet në një nga lagjet më të populluara të qytetit, ku jeton një pjesë e konsiderueshme e komunitetit, pikërisht në Bathore. Duke pasur parasysh që kjo zonë është në zhvillim e sipër, projekti i rrugës është bërë me parametra që t’i përshtaten zhvillimit të zonës, si dhe duke pasur parasysh edhe kërkesat dhe nevojat e vetë qytetarëve, për të pasur lirshmëri në hyrje-daljet nga shtëpitë, por edhe lehtësimin e lëvizjes gjatë gjithë segmentit rrugor.

### Lagjes nr. 2 Kamëz i shtohet një tjetër investim, kanalizimet në rrugën “Fatmirësia”



Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve në rrugën “Fatmirësia” në lagjen nr. 2 Kamëz është projekti i radhës që do të realizohet në këtë zonë gjatë vitit 2017.

Gjatësia ku do të kryhet investimi është L=300 ml në të cilën do të përdoren tuba Ø 110. Ky projekt do të shërbejë për mijëra banorë të zonës, duke bërë të mundur shkarkimin e ujërave të ndotura. Kjo KUN në rrugën “Fatmirësia” ka një rëndësi të madhe sociale e mjedisore. Impakti social që sjell zbatimi i këtij projekti do të jetë i jashtëzakonshëm, pasi u vjen në ndihmë mijëra banorëve të lagjes 2 në Kamëz, duke përmirësuar infrastrukturën e kanalizimeve, si dhe duke shmangur ndotjen e mjedisit. Me fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2017, Bashkia Kamëz do të bëjë të mundur realizimin edhe të këtij projekti jetik për banorët, pasi me përfundimin e tij do të merrte zgjidhje një prej problemeve shqetësuese të qytetarëve.

### Ndërtimi i kanalizimeve në rrugën “Aleks Buda” në Paskuqan 2 Vresht, investim i dobishëm për qytetarët e zonës



Ndër projektet e shumta të investimeve që Bashkia Kamëz do të zbatojë këtë vit është edhe ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura në rrugën “Aleks Buda” në lagjen Paskuqan 2 Vresht. Ndërtimi i KUN-së së rrugës “Aleks Buda” do të përmirësojë ndjeshëm gjendjen e kanalizimeve të banesave që ndodhen në këtë pjesë të Njësisë Administrative Paskuqan, duke i dhënë zgjidhje gjendjes së trashëguar, e cila ka qenë mjaft problematike. Segmenti rrugor ku do të investohet ka gjatësi përkatësisht L = 240 ml. Për ndërtimin e rrjetit do të përdoren tuba me diametër Ø 200 dhe Ø 300. Bashkia Kamëz, si institucioni që ka lidhje të drejtpërdrejtë me qytetarët dhe problematikën e tyre, ka hartuar dhjetëra projekte në fusha jetike. Një ndër to është edhe ndërtimi i kanalizimeve në rrugët e Kamzës dhe të Paskuqanit. Ashtu siç ka ndodhur edhe vitet e mëparshme, investimet publike do të jenë kryefjala e punës së Bashkisë, e cila jo vetëm në këtë zonë, por kudo në territorin e saj ka bërë të mundur dhjetëra projekte me ndikim të jashtëzakonshëm social.

### Bashkia projekton një tjetër investim të rëndësishëm, rrjeti i kanalizimeve në lagjen 4 Kamëz



Bashkia projekton një tjetër investim të rëndësishëm. Bëhet fjalë për rrjetin e kanalizimeve në lagjen 4 Kamëz, përgjatë rrugës “Montekarlo”. Projekti i ndërtimit të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura (KUN) në rrugën “Montekarlo” në lagjen 4 Kamëz është parashikuar për vitin 2017, së bashku me dhjetëra projekte të tjera. Ndërkohë që nga ana e qeverisë financimet e projekteve të ndryshme infrastrukturore për Kamzën kanë qenë zero në katër vite, në buxhetin e Bashkisë janë parashikuar dhjetëra investime, të gjitha nga të ardhurat e veta. Duke parë shqetësimin e qytetarëve, është marrë parasysh edhe mendimi i komunitetit për realizimin e investimeve. Në kuadrin e këtij bashkëpunimi, është hartuar edhe projekti për ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura në rrugën “Montekarlo” në lagjen 4 Kamëz. Segmenti ku do të investohet ka gjatësi prej 467 ml. Realizimi i investimit ndikon jashtëzakonisht në jetesën e familjeve që jetojnë e banojnë në këtë zonë. KUN-ja që do të ndërtohet, do të lehtësojë shkarkimin e ujërave të ndotura, duke shmangur rrezikun e përmbajtjeve në rast reshesh të shumta. Gjatë segmentit rrugor do të bëhet ndërtimi i rrjetit të KUN-së do të përdoren tuba të diametrit Ø 400; Ø 600, Ø 800.



## Kryebashkiaku Mziu gjatë punimeve për rivitalizimin në Qendër-Babrru: Do ta bëjmë një qytet më të këndshëm



ka qenë në kushte komode si të gjitha bashkitë e tjera, sepse mbështetja e qeverisë ka munguar. Plot 135 projekte kemi paraqitur për t'u financuar nga qeveria qendrore dhe, në fakt, asnjë projekt nuk është financuar.

Kemi dërguar edhe këtë investim që po bëhet, kemi dërguar edhe rrugën kryesore.

Të mos harrojmë që ky investim që po inaugurojmë kushton jo pak, por 1 miliard e 400 milion ose më tepër sesa 1 milion euro, që do të bëhet me taksat që paguajnë familjarët dhe me taksat që paguajnë bizneset. Është rruga kryesore që ka një gjatësi prej 7 km dhe që i kushton jo pak, por 2 miliardë e 600 milionë lekë ose e thënë ndryshe 2 milionë euro.

Kryetari i Bashkisë së Kamzës, z. Xhelal Mziu, ishte i pranishëm në përrurimin e punimeve për rivitalizimin urban të qendrës së Babrrit. Duke folur para banorëve të zonës, z. Mziu i siguroi ata se me këtë investim, Babrrit do të kthehet në një qytet më të këndshëm për ta. "Siç e shihni, jemi në inaugurimin e rivitalizimit të qendrës së Babrrit. Mbj mend si dy vite më parë, në komunikimin që kam pasur me banorët e këtyre pallateve, ishin mosbesues, ishin mosbesues edhe për ujën, edhe për rrugën, edhe për ndriçimin, edhe për gjelbërimin, por në këto dy vite Bashkia e Kamzës nuk

Janë edhe 20 e sa projekte të tjera rrugësh dhe më shumë sesa 20 projekte të tjera kanalizimesh, të cilat kanë filluar që para 6 muajsh dhe janë në investim e sipër dhe në prokurim e sipër dhe që të gjitha këto kushtojnë jo pak, por kushtojnë më shumë sesa 7 miliardë lekë, të cilat kanë ardhur pjesërisht nga taksat e familjarëve dhe të bizneseve në zonën e Paskuqanit, por kryesisht nga ato të Kamzës.

Unë kisha premtuar që Paskuqani do të ishte motivi kryesor i punës së Bashkisë në katër vitet që do të vijnë dhe më shumë sesa 70% e buxhetit të Bashkisë ka ardhur në Paskuqan dhe këtë e kam bërë se zona e Paskuqanit është shumë mbrapa



me investime krahasuar me Kamzën edhe me Bathoren. Unë e konsideroj një zonë që është shumë vitale, shumë e domosdoshme për t'u zhvilluar. Sot kemi filluar këtë investim me një kompani mjaft serioze. Ju do të jeni dëshmitarë, në më pak se 4-5 muaj do të kthehet në një qendër qyteti që do të tjetërsohet edhe me rrugë, edhe me trotuare, edhe me ndriçim, edhe me gjelbërim, edhe me rivitalizim pallatesh, çfarë do të thotë që do ta bëjmë një qytet më të këndshëm", - tha ndër të tjera në fjalën e tij kryebashkiaku Mziu.

### Lagjja Paskuqan 2, përfituese e një tjetër investimi të Bashkisë Kamzë në vitin 2017, ndërtimi i rrugës "Bule Naipi"



Lagjja Paskuqan 2 do të jetë përfituese e një tjetër investimi të Bashkisë Kamzë, ndërtimi i rrugës "Bule Naipi". Ajo shërben si arterie lidhëse e mijëra banorëve me rrugën kryesore "Demokracia". Kjo rrugë aktualisht është funksionale, por e pashtruar me asfalt. Ndërtimi i saj në atë lagje ka një rëndësi të madhe sociale dhe ekonomike, pasi ndikon në qarkullimin e lirë të automjeteve dhe të njerëzve. Rruga "Bule Naipi" bën lidhjen e një zone, që është shumë e populluar, me lagjet e tjera të Paskuqanit, por edhe me Kamzën dhe Tiranën. Kjo rrugë do të ketë një gjatësi prej 260 m, me gjerësi 4 m, me kune të dhe me trotuare në të dyja anët e rrugës. Në zgjidhjen planimetrike është pasur parasysh që asfaltimi i rrugës të bëhet në gjithë aksin e rrugës ekzistuese dhe të lihen hapësirat e nevojshme për zhvillimin e infrastrukturës nëntokësore, duke sistemuar rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe linjat e ujësjellësit. Kështu, Bashkia vijon investimet në infrastrukturën rrugore në Paskuqan, por edhe në Kamzë. Vetëm gjatë vitit 2017 janë parashikuar të realizohen 50 projekte infrastrukturorë.

### Investimet e Bashkisë Kamzë në vitin 2017 vijnë me ndërtimin e rrugës "Ndoc Gjetja" në Babrru-Kodër



Investimet e Bashkisë Kamzë në vitin 2017 do të vijnë me ndërtimin e rrugës "Ndoc Gjetja" në Babrru-Kodër. Kështu, një tjetër rrugë me parametra bashkëkohore do t'i shtohet zonës së Njësisë Administrative Paskuqan. Bashkia ka parashikuar që të ndërtojë këtë vit rrugën "Ndoc Gjetja", e cila ndodhet në lagjen Babrru-Kodër. Rruga "Ndoc Gjetja" është një segment që lidh banorët e zonës me rrugët "Konferenca e Bujanit", "Mustafa Kruja" dhe rrugën "Halit Haxhia".

Projekti i këtij segmenti rrugor, ku do të investohet, ka gjatësi 370 m e gjerësi prej 5 m. Rruga "Ndoc Gjetja" ka një rëndësi të veçantë për zonën, pasi jep impakt mjaft pozitiv për banorët e saj, duke qenë se ndodhet në një nga lagjet më të populluara të Paskuqanit, ku jeton një pjesë e konsiderueshme e komunitetit.

### Rruga "Leka i Madh", një tjetër investim që i shtohet lagjes Paskuqan 1 në vitin 2017



Rruga "Leka i Madh" është një tjetër investim që do t'i shtohet lagjes Paskuqan 1 në vitin 2017. Mes projekteve të shumta të Bashkisë Kamzë për këtë vit është ai për ndërtimin e rrugës "Leka i Madh", e cila ndodhet në lagjen Paskuqan 1 dhe kufizohet me rrugën "Lidhja e Prizrenit" dhe bën lidhjen e disa segmenteve të tjera rrugore. Për këtë arsye ndërtimi i saj merr rëndësi të madhe, duke qenë se i vjen në ndihmë një numri të konsiderueshëm banorësh.

Janë kërkesat e këtyre banorëve që ka marrë parasysh Bashkia për të hartuar një projekt bashkëkohor për ndërtimin e rrugës "Leka i Madh", me gjatësi prej 258 m dhe gjerësi 4 m.

Kjo, me qëllimin për të ofruar një infrastrukturë të standardeve ndërkombëtare për qytetarët e zonës dhe për të bërë të mundur edhe zhvillimin e bizneseve përgjatë kësaj rruge, gjë e cila do të ndikojë në rritjen e numrit të të punësuarve.

### Ndërtimi i kanalizimeve dhe i rrugës "Veli Dede" në Fushë-Kërçik, vijim i investimeve të Bashkisë Kamzë në Paskuqan



Ndërtimi i kanalizimeve dhe i rrugës "Veli Dede" në lagjen Fushë-Kërçik të Paskuqanit është vijim i projekteve që do të realizohen nga Bashkia Kamzë gjatë vitit 2017.

Ky investim ka një rëndësi të madhe, si ekonomike ashtu edhe sociale, pasi ndikon në lehtësimin e qarkullimit të automjeteve dhe të njerëzve, duke qenë edhe një nyjë e rëndësishme lidhëse e banorëve me rrugët e tjera.

Gjatësia e segmentit ku do të realizohet investimi është 380 m dhe gjerësia 5.5 m. Rruga "Veli Dede" është një arterie lidhëse me Rrugën e Kërçikëve, e cila lidhet me rrugën kryesore "Demokracia".

Kjo rrugë aktualisht është funksionale, por në zgjidhjen planimetrike është pasur parasysh që të bëhet asfaltimi i saj dhe të krijohej infrastruktura nëntokësore, duke ndërtuar sistemin e kanalizimeve.

### Në lagjen Paskuqan 1, së shpejti nis ndërtimi i rrugës "Halim Xhelo"



Në lagjen Paskuqan 1, do të nisë ndërtimi i rrugës "Halim Xhelo". Ajo do të shërbejë si një arterie lidhëse e rrugës kryesore "Demokracia" me rrugën "Besim Çera", duke qenë kështu një investim mjaft i rëndësishëm për komunitetin e zonës. Rruga "Halim Xhelo" bën lidhjen e një zone, që është shumë e populluar, me lagjet e tjera të Paskuqanit, por edhe të zonave të tjera.

Kjo rrugë do të ketë një gjatësi prej 812 m, me gjerësi 4 m. Në zgjidhjen planimetrike është pasur parasysh që asfaltimi i rrugës të bëhet në gjithë segmentin e rrugës ekzistuese, duke ndërtuar edhe rrjetin e kanalizimeve. Në kryqëzime është do të bëhet rakordimi i kthesave me rreze të tillë, që të lejojë kthimin normal të automjeteve, si dhe të lehtësojë edhe kalimin e këmbësorëve. Ndërtimi i saj në atë lagje ka një rëndësi të madhe sociale dhe ekonomike, pasi ndikon në lehtësimin e lëvizjes së këmbësorëve dhe të automjeteve. Gjithashtu, ky investim do t'i japë një impuls pozitiv edhe zhvillimit të bizneseve, të cilat do të bëjnë të mundur hapjen e vendeve të reja të punës.



## Kryebashkiaku Mziu, i pranishëm në takim me anëtarin e Komisionit për Çështjet e BE-së në Bundestagun Gjerman, Thorsten Frei

**Z. Mziu foli për situatën e pushtetit vendor në Shqipëri, veçanërisht për gjendjen në të cilën ndodhet Bashkia Kamëz dhe sfidat e saj në katër vitet e fundit, gjatë qeverisjes së majtë**

Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, ishte i pranishëm në një takim me anëtarin e Komisionit Parlamentar për Çështjet e BE-së në Bundestagun Gjerman, z. Thorsten Frei,



njëherësh deputet i CDU-së. Takimi ishte i organizuar nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë dhe fondacioni "Konrad Adenauer Stiftung". Z. Mziu foli për situatën e pushtetit vendor në Shqipëri, veçanërisht për gjendjen në të cilën ndodhet Bashkia Kamëz dhe sfidat e saj në katër vitet e fundit, gjatë qeverisjes së majtë. Anëtarin e Komisionit Parlamentar për Çështjet e BE-së në Bundestagun Gjerman, z. Thorsten Frei, foli për përvojën, rolin e bashkive, rolin e BE-së dhe të institucioneve të saj në mbështetje të bashkive. Ndërkaq, deputetja e PD-së në Kuvendin e Shqipërisë, znj. Jorida Tabaku, foli për qasjen parlamentare dhe modelin demokrat për pushtetin vendor nesër. Diskutimet e tjera kishin të bënin me reformën administrative-territoriale dhe nevojat për hapa të mëtejshëm në këtë drejtim apo çështja të tilla që kanë të bëjnë me bashkitë dhe bashkëpunimin ndër-institucional.

Konferenca kishte për qëllim:

- të prezantonte këndvështrimin e dinamizmit të bashkive në vendet perëndimore lidhur me normat, rregullat dhe parimin e subsidiaritetit: "Sipas parimit të subsidiaritetit, përgjegjësitë dhe shërbimet publike, funksionet rregullatore

dhe shpenzimet janë transferuar në nivelin më të ulët institucional apo shoqëror, më të afërt për qytetarët dhe që janë në gjendje t'i përmbushin ato".

- njohje me instrumentet e Bashkimit Evropian si mundësi për bashkitë shqiptare;

- reflektim mbi situatën aktuale dhe sfidat e pushtetit vendor dy vjet pas reformës territoriale.

I ftuar i veçantë në këtë konferencë, deputeti gjerman i CDU-së, z. Thorsten Frei - anëtar i Komisionit Parlamentar për Çështjet e BE-së në Bundestagun Gjerman dhe njëkohësisht edhe raportuesi për Shqipërinë - është njohës shumë i mirë i çështjeve të pushtetit vendor si edhe ish-kryebashkiak i qytetit Donaueschingen.



### Sfidat e Bashkisë Kamëz në katër vjet

Në katër vjet të qeverisjes së majtë, Bashkia Kamëz është përballur dhe vazhdon të përballë me sfida të mëdha. Ndër kryesoret është realizimi i investimeve publike, aq të nevojshme për banorët e Kamzës. Po në dallim nga periudhat e mëparshme, gjatë katër viteve të fundit, Bashkia, qyteti i Kamzës dhe banorët e saj janë përballur me indiferencën dhe arrogancën e një qeverie ndaj qytetarëve të kësaj njësie vendore. Dhe pikërisht në mungesën e financimeve është vërejtur më së shumti kjo indiferencë, si para, ashtu pas miratimit dhe zbatimit të reformës administrative-territoriale. Nga ana e qeverisë nuk i është dhënë hapësirë Bashkisë për të pasur kompetenca për të vepruar apo edhe për të pasur financime. U deklarua se pushtetit vendor do t'i kalonin shtatë

kompetenca të reja, por në fakt kjo nuk ka ndodhur. Pushtetit vendor jo vetëm që nuk i janë deleguar kompetenca, por i janë rritur kostot financiare krahasuar kjo me të kaluarën. U tha se arsimi parashkollor dhe personeli ndihmës parauniversitar do të kalojë në kompetencë të pushtetit vendor. Ajo që bëhet sot me fondet e Bashkisë është thjesht pagesa financiare e këtij personeli në bazë të listë-prezencës që vjen nga Drejtoria Arsimore Rajonale. Një tjetër kompetencë e mohuar është ajo



e menaxhimit të sektorit të zjarrfikëseve. Në Kamëz ka pasur një stacion zjarrfikësesh, por ka ndodhur që pas delegimit të kompetencave ky repart i ka kaluar Bashkisë së Tiranës. Pra në Kamëz, ku ka më shumë se 150 mijë banorë, nuk ka as repart zjarrfikësesh. Tjetër problematikë është në administrimin e pyjeve dhe kullotave. Bashkia Kamëz ka qindra ha pyje dhe kullota, por edhe pse këto zona kanë kaluar nën administrimin e pushtetit vendor, nuk ka asnjë financim për mirëmbajtjen e tyre apo dhe personelin. Tjetër kompetencë që ka kaluar në vartësi të pushtetit vendor është administrimi i qendrave ditore sociale, por jo për Kamzën e cila ka një azil të ndërtuar në vitet '70. Kjo qendër, edhe pse është në pronësinë e Bashkisë, nuk ka kaluar në administrim e saj dhe është e vetmja qendër sociale në të gjithë territorin e vendit që menaxhohet nga Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale. Tjetër delegim kompetencash për pushtetin vendor ishte ai i konvikteve të shkollave. Në Kamëz gjendet konvikti i shkollës "Loro Boriçi", por që i ka kaluar edhe ky për menaxhim Bashkisë së Tiranës, një rast ekstrem ky, që një konvikt i një njësie vendore i kalon për menaxhim një njësie tjetër, që as nuk e ka në territorin e saj. Në shkurt të këtij viti qeveria vendosi që të blinte 61 ekskavatorë në ndihmë të pushtetit vendor, Bashkia e Kamzës nuk ka asnjë ekskavator, ndërsa Bashkia e Tiranës ka dy.

## Mbledhja e Këshillit Bashkiak Kamëz, miratohen të gjitha projektvendimet

Në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Kamëz u paraqitën para këshilltarëve disa projektvendime, të cilat u miratuan të gjitha. Një pjesë e rëndësishme e këtyre projektvendimeve është miratimi i dhënies së ndihmës ekonomike për personat me aftësi të kufizuara për periudhën 1 deri 30 prill 2017. Po kështu, u miratua edhe dhënia e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë në Kamëz dhe Paskuqan, si dhe dhënia e kompensimit të energjisë elektrike për muajin mars 2017 dhe projektvendimi për rastet e veçanta për muajin prill të po këtij viti. Dhënia e kësaj ndihme ka të bëjë me trajtimin me ndihmë ekonomike me fondet e buxhetit vendor për familjet me shumë anëtarë apo për familjet e varfra, kjo duke u bazuar në disa kritere, siç janë familjet me fëmijë jetimë; familje të ngujuara për hasmëri; familje që jetojnë në baraka, pa ta ardhura; të moshuar të vetmuar dhe pa kujdestari; familje me persona me aftësi të kufizuara dhe në kushte shumë të vështira e pa ta ardhura të tjera; familje me kryefamiljarë në burg dhe fëmijë të vegjël; familje që pavarësisht nga disa kritereve jetojnë shumë keq, pa të ardhura, pa punë, me fëmijë vetëm vajza etj.; familje që kanë probleme të mëdha shëndetësore dhe kërkojnë ndërhyrje të rënda kirurgjikale etj. Një projektvendim i rëndësishëm ishte edhe ai për linjat e rregullta të transportit të udhëtarëve, qytetëse dhe rrethqytetëse, që operojnë në Bashkinë Kamëz. Kujtojmë se tashmë janë shtuar linja të reja të këtij lloji transporti, të cilat lehtësojnë edhe më shumë lëvizjen e banorëve në qytetin e Kamzës dhe jashtë tij.

## Kryebashkiaku Xhelal Mziu: Urime mikut tim Ramush Haradinaj! Më në fund drejtësia triumfoi

Kryebashkiaku Xhelal Mziu shpreh urimet e tij për lirimin e Ramush Haradinajt. Vendimi për lirimin e drejtuesit dhe komandantit legjendar të UÇK-së dhe të luftës heroike për pavarësinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, është pritur me entuziazëm nga kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, i cili e konsideron një tjetër betejë të fituar nga ish-kryeministri i Kosovës në luftën e tij të drejtë. Duke shprehur mendimin e tij, të qytetarëve të Kamzës, por edhe të gjithë shqiptarëve, kryebashkiaku Mziu shpreh urimet më të sinqerta për z. Haradinaj, familjen dhe bashkëpunëtorët e tij, si dhe për çdo shqiptar në Kosovë, Shqipëri dhe kudo në botë. Gjithashtu, z. Mziu shpreson që ngjarje të tilla, siç ishte ndalimi i padrejtë i kreut të AAK, njëkohësisht "Qytetar Nderi" i Kamzës, Ramush Haradinaj, të mos përsëriten më dhe shqiptarët të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë si qytetarë të vërtetë evropianë.

### Kush është Ramush Haradinaj

Ramush Haradinaj lindi më 3 korrik 1968 në Glllogjan, afër Deçanit. Është një politikan dhe ish-udhëheqës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Prej datës 3 dhjetor 2004 deri më 8 mars 2005 ka qenë Kryeministër i Kosovës. Ramush Haradinaj ishte komandant në Zonën Operative të Dukagjinit të UÇK-së. Pas luftës me transformimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) ai emërohet zëvendëskomandant i TMK-së. Në prill të vitit 2000 largohet nga jeta ushtarake dhe themelon



partinë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), kryetar i së cilës është edhe sot. Më 3 dhjetor 2004 në Parlamentin e Kosovës u zgjodh Kryeministër me shumicë votash. Më 8 mars të vitit 2005, Gjykata për Krime të Luftës në ish-Jugosllavi publikoi aktakuzën për krime lufte ndaj tij dhe si rrjedhojë po atë ditë Haradinaj dha dorëheqje nga posti i Kryeministrit të Kosovës, në mënyrë që të përballë me aktakuzën e ngritur nga Gjykata. Ai të nesërmen shkoi vullnetarisht në gjykatën e Hagës, ku me të mbërritur u burgos. Me gjithë akuzat dhe sulmet e herëpashershme, Ramush Haradinaj ia ka dalë fitojë çdo betejë, e fundit prej të cilave ishte ajo në Francë.



# Gënjeu për legalizimet falas në 2013, Rama rikthehet në Kamëz, aty ku mashtroi shqiptarët

**Pyesim Kryeministrin: Sa legalizime falas ke bërë në Kamëz dhe Paskuqan?! Letrat e Artan Lames në Bashki, për të përfituar sekserët tuaj. Vetting-un nuk e do Kryeministri hajdut. PS është dërrmuar në Kamëz**

Edi Rama, Kryeministri më i dështuar që pas rënies së komunizmit në Shqipëri, kryemashtues, promovuesi i krimit në politikë, erdhi përsëri në Kamëz dhe në vend të llogaridhënies ndaj qytetarëve, paturpësisht u mundua që të merrej me batuta, siç bën në çdo takim, duke mos pasur bilanc të punës së tij për 4 vjet. Rama, teksa shpërndante disa leje

për truallin, nëse dikush tregonte që kishte paguar 1 vit rresht energjinë!

Ky Kryeministër i ka masakruar banorët e Kamzës dhe Paskuqanit gjatë qeverisjes së tij me faturat e fryra të energjisë, me aksionet dhunuese ndaj tyre, ku nuk ka munguar as shoqërimi në polici i tyre, kallëzimi në prokurori për ata që nuk kanë pasur mundësi

që ka ardhur në Bashkinë Kamëz ka pasur si qëllim: për të përfituar sekserët e tij (pra kërkesat kanë qenë joligjore, pasi kanë legalizuar objekte jashtë kritereve.

Ka sjellë shkresa për t'u llogaritur faturën e pagesës "legalizimeve falas" të qeverisë "Rama". Janë mbi 20 mijë objekte të palegalizuara ende në Kamëz dhe nuk duan ta bëjnë legalizimin me lekë me këtë qeveri, por falas me PD-në. Kunati i kryebashkiakut Xhelal Mziu nuk e donte legalizimin, nuk e ka paguar vlerën kolosale të legalizimit, është false, ajo çfarë bëri Rama ishte një show.

Sa u përket emërtimit të rrugëve, Xhelal Mziu nuk i druhet vetting-ut dhe këtë e di mjaft mirë Rama. Vetting-un nuk e do Kryeministri hajdut. Sa u përket emërtimeve të rrugëve, Kamza ka rrugë Trump-Zhvillim-Drejtësi, qeveria Rama ka emrin Soros-Drogë-Korrupsion. Rama e ka parë politikisht Kamzën dhe i ka diskriminuar banorët, të cilët kanë vetëm një kundërshtar dhe ai je ti Rama.

I kujtojmë këtij Kryeministri hakmarrës se në Kamëz hoqi 5 mijë familje nga skema e ndihmës ekonomike, duke u mohuar edhe kafshatën e gojës, papunësia është rritur më shumë në këto vite, varfëria është ulur këmbëkryq në Kamëz.

Banorët e Kamzës dhe Paskuqanit si të gjithë shqiptarët janë dëshmitarë që ky Kryeministër mashtrues nuk ka mbajtur asnjë premtim.

I kujtojmë Ramës se z. Xhelal Mziu vazhdon që të drejtojë Bashkinë e Kamzës, falë besimit të qytetarëve te platforma dhe puna e tij ndaj dhe ai e PS kanë shkuar nga humbje në humbje në Kamëz.

## Kryeministri në Kamëz, s'ka guxim të dalë në shesh, aty ku bëri premtimet që nuk i mbajti

Kryeministri erdhi sërish në Kamëz, por duke mos pasur guximin të dalë në shesh, përpara qytetarëve, aty ku bëri premtimet e bujshme katër vjet më parë e që nuk i mbajti. Erdhi në Kamëz dhe foli për projekte, duke e ditur fare mirë se nuk ka financuar asnjë të tillë për banorët e këtij qyteti, që ka nevoja të shumta në çdo fushë. Janë 135 projekte të hartuara nga Bashkia Kamëz, që i janë dërguar katër vjet rresht e që "fleenë harruar" nëpër sirtarët e Kryeministrit dhe të ministrive. Janë projekte që do të shkonin në dobi jo vetëm të demokratëve, që e kanë turpëruar me votë gjithnjë, por edhe të qytetarëve me bindje të majtë apo bindje të tjera politike. Ndërkaq, Bashkia ka të gatshme projekte jo vetëm në infrastrukturën rrugore, atë të ujësjellës-kanalizimeve, arsimore, shëndetësore, të cilat janë fushat më jetike, por edhe në sport, kulturë etj., të cilat presin financimin e tyre.

Kryeministri futet në një ambient të vogël dhe nuk ka guximin të dalë më në sheshin e qytetit, sepse ndihet fajtor para të paktën gjysmës së qytetarëve të Kamzës, ata të majtë (meqë përbëjnë pothuaj 50% të banorëve të krejt qytetit). Ku i ka premtimet e 2013-ës, të shpallura me aq pompozitet, duke e ditur qysh atëherë që asnjë projekt nuk do të financonte për qytetarët që po e ndiqnin atë ditë qershori?! Nuk i mjaftojnë studiot e televizioneve që i ka pushtuar ditë-natë, por tani me televizionin e tij personal, si narcizist, shfrytëzon çdo mundësi për të shitur përrallat e tij, duke kaluar çdo situatë me batuta të dala boje, i ndodhur para llogaridhënies ndaj qytetarëve shqiptarë.



legalizimi, harroi të kërkonte falje për një nga megamashtimet e tij për të gjithë shqiptarët bërë në qershor 2013 në Kamëz se me ardhjen e tij në pushtet legalizimet e ndërtimeve pa leje do të bëheshin falas.

Ky premtim nuk u bë realitet dhe kjo u pa qartë edhe në këtë takim, teksa Rama, në vend të ndjesës ndaj qytetarëve që nuk mundi të mbante premtimin, rrekej të pohonte që "nuk keni paguar për procedurën!" E pyesim Ramën: Sa legalizime falas ke bërë në Kamëz, Paskuqan dhe Shqipëri?! Jo vetëm që nuk kërkoi ndjesë, por Rama tallet me banorët teksa pohon se e ulën faturën përkatëse edhe

ekonomike të paguajnë energjinë dhe për raste janë detyruar të lidhin energjinë apo edhe mjaft familje që kanë ndenjur me muaj të tërë në errësirë!

I kujtojmë Ramës që në Kamëz dhe Paskuqan ka futur padrejtësisht e përjetësisht në borxh për energjinë e pakonsumuar mijëra familje. Sa u përket letrave të Lames dhe bashkëpunimit të pretenduar nga Kryeministri mes ALUIZNI-t dhe Bashkisë dhe qeverisë i kujtojmë Ramës se Bashkia Kamëz ka dërguar mbi 135 projekte në qeveri dhe zero financim ka pasur nga qeveria "Rama". Çdo letër e legalizimit e Artan Lames

## Bashkia Kamëz: Të rinjtë në Kamëz të distancohen nga Saimir Tahiri dhe qeveria e drogës

**Nga 2013-ta, Kamza është diskriminuar nga Edi Rama. 135 projekte të dërguara nga Bashkia për financim që fleenë në sirtarët e qeverisë. Pyetja që i shtrojmë Tahirit është: Cili është bilanci i qeverisë Rama në Kamëz në këto 4 vite?!**

Saimir Tahiri, kreu i bandave të krimit dhe trafikeve në vend, guxoi nga Kamza me të rinjtë që votojnë për herë të parë, të cilët u nxorën me urdhër nga mësimi, të mohojë zhvillimin e Kamzës në këto 20 vite. Rinia e Kamzës duhet të distancohet nga Tahiri, pasi veç kultivimit dhe trafikimit të drogës, nuk ka për çfarë të t'u flasë tjetër, pasi vetëm në këtë fushë ka bilanc pozitiv.

Tahiri, ashtu si shefi i tij Rama, udhëheqësit më të lartë të krimit në politikë dhe qeverisje, nuk kanë asnjë shans ballafaqimi në Kamëz, ndaj vijnë e struken diku në qytet me një grusht njerëzish dhe tentojnë të bëjnë politikë të madhe, atakojnë arritje, por harrojnë që për banorët e Kamzës ata janë kryemashtues.

I kujtojmë Saimir Tahirit se në Kamëz janë ndërtuar me qindra kilometra rrugë; 18 shkolla dhe kopshte; Pallati i Kulturës; palestra e lojërave me dorë në Bathore; qindra kilometra rrjet të kanalizimeve të ujërave të zeza. Përfundimi i fazës së parë të projektit të ujësjellësit me KfW-në mundëson që 70% të Kamzës të furnizohet tashmë rregullisht



me ujë të pijshëm. Janë me qindra projekte infrastrukturore që Bashkia Kamëz, e gjendur përballë bllokadës qeveritare, po investon me fondet e buxhetit të saj nga mirëmenaxhimi i taksave vendore. Vlen të përmendet rruga "Demokracia" në Paskuqan, 7 km e gjatë,

punimet e së cilës po ecin me ritme të shpejta, investim ky me fondet e Bashkisë. Janë në proces edhe investime të tjera madhore, si: rikualifikimi urban i qendrës në Babrru. Prioritet i Bashkisë është edhe ndërtimi i sheshit të ri në qendër të qytetit Kamëz,

pranë Pallatit të Kulturës, me sipërfaqe 3936 metra katrorë, si dhe ndërtimi i pedonales përgjatë "Bulevardit Blu". I kujtojmë Tahirit se prej vitit 2013 Kamza dhe banorët e saj janë diskriminuar nga Edi Rama. Janë 135 projekte të dërguara nga Bashkia për financim që fleenë në sirtarët e qeverisë. Nga qeveria, pjesë e së cilës ishte dhe Tahiri deri para pak ditësh, është financuar vetëm rikonstruksioni i qendrës shëndetësore Kamëz! Tahiri dhe Rama përpara se të flasin në tymnajë për mbajtjen peng të Kamzës, kanë llogari për të dhënë ndaj banorëve të qytetit më vital në Shqipëri, qytetin e njerëzve me dinjitet dhe të punës. Gjatë qeverisjes së tyre jo vetëm që nuk kanë mbajtur kryepremtimin e firmosur nga Rama në Kamëz për legalizimet falas, por nuk kanë mbajtur asnjë premtim tjetër. E kundërta ka ndodhur, banorët e Kamzës dhe Paskuqanit janë masakruar nga kjo qeverisje deri në burgosje për një faturë të papaguar të energjisë apo vënien e një tulle avllie etj. Pyetja që i shtrojmë Tahirit është: Cili është bilanci i qeverisë Rama në Kamëz në këto 4 vite?!



## Policia Bashkiake vijon punën për lirim e hapësirave publike dhe garantimin e investimeve në Bashkinë Kamëz

Policia Bashkiake ka vijuar punën e saj për lirim e hapësirave publike dhe garantimin e firmave ndërtuese të cilat po realizojnë investime të ndryshme në territorin e Bashkisë Kamëz.

Aksioni është përqendruar në të gjitha segmentet rrugore, mes të cilave rruga "Demokracia" në Paskuqan, si dhe në rrugët apo hapësirat publike në mbarë qytetin. Strukturat e Policisë Bashkiake kanë intensifikuar punën për piketimin dhe lirim e hapësirave publike në zonën e Paskuqanit në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Investimeve Publike e Rrugëve (Urbanistika) dhe Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit (IVMT), duke qenë pjesë e gjashtë grupeve pune.

Pjesë e rëndësishme e Policisë Bashkiake ka qenë heqja e pengesave (apo siç njihen ndryshe "policët e shtrirë") në rrugët ku ka pasur ankesa nga ana e qytetarëve.

Në të gjitha rastet e konstatuara, Policia Bashkiake, në zbatim të ligjit, ka ndërmarrë hapat e nevojshëm duke hequr këto pengesa.

Po ashtu, edhe në rastet e ndërtimeve të paligjshme, Policia Bashkiake në bashkëpunim me IVMT-në ka konstatuar nga afër gjendjen dhe ka vijuar me procedurën përkatëse në përputhje me ligjin. Ndërkaq, nga ana e saj është bërë edhe kontrolli në terren i firmave ndërtuese të rrugës "Demokracia" për mbarëvajtjen e punës dhe mospengimin e tyre, me qëllim realizimin në kohë dhe cilësi të investimit.

Ndërkaq, ka prishur të gjitha objektet dhe muret rrethuese në të dyja anët e rrugës "Demokracia" me distancat e përcaktuara nga Urbanistika, në bashkëpunim me IVMT-në.

Policia Bashkiake në kuadër të përmbushjes së detyrave të saj funksionale, ka ushtruar gjithashtu



kontroll në të gjithë territorin e Bashkisë për sa i përket lirimit të hapësirave publike të zëna nga tregtarët ambulantë.

**/// Sekretari i Përgjithshëm i TDBB, Fahri Solak: "Si TDBB, ne jemi të nderuar për ardhjen tuaj në këtë delegacion të rëndësishëm. Ne jemi të gatshëm të bëjmë projekte të përbashkëta për zhvillimin e bashkëpunimit në qeveritë vendore me Shqipërinë".**

## Punë intensive e Drejtorisë së Urbanistikës për realizimin e projekteve në infrastrukturën e qytetit



Drejtorja e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Investimeve Publike e Rrugëve (Urbanistika) po vijon punën intensivisht për sa i përket realizimit të projekteve në infrastrukturën e qytetit të Kamzës. Në kuadër të kësaj pune, përveç hartimit të projekteve konkurruese sipas standardeve bashkëkohore, kjo drejtori ushtron kontroll në terren të investimeve të tilla si rehabilitimi i rrugës "Demokracia" në Njësinë Administrative Paskuqan apo dhjetëra projekteve që po realizon Bashkia Kamëz, duke i financuar të gjitha vetëm me të ardhura e veta.

Me qëllim zbatimit brenda afateve dhe sipas të gjitha kritereve dhe cilësisë së duhur, nga ana e punonjësve të kësaj drejtorie ka pasur një angazhim të vazhdueshëm dhe maksimal.

Gjithashtu, për t'i paraprirë zbatimit në terren të këtyre projekteve, bëhet piketimi dhe hapja e hapësirave publike për rrugët dhe investimet e tjera sipas grupeve të punës.


Kjo, në bashkëpunim edhe me struktura të tjera të Bashkisë, si

Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit; Policia Bashkiake etj.

Kjo drejtori ushtron kontroll, i shqyrton dhe u kthen përgjigje edhe kërkesave për leje zhvillimi, leje prishjeje dhe leje ndërtimi të ardhura online.

Ndërkaq, pjesë e punës së Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Investimeve Publike e Rrugëve gjatë kësaj periudhe ka qenë edhe aplikimi online për leje zhvillimi infrastrukturë të 20 projekteve, aplikimi online dhe dhënia e lejeve të ndërtimit, aplikimi online për deklaratë punimesh, riparim shkollash në Paskuqan. Me një ritëm të lartë pune vijon edhe hedhja e të dhënave në programin e sistemit GIS të objekteve (biznese dhe banesa), numri i të cilave i ka kaluar 12 mijë. Po ashtu, vijon edhe kontrolli në terren i lejeve të ndërtimit, korrespondenca me institucione të ndryshme shtetërore, hedhja e tabelave që vijnë nga ALUIZNI për taksën e infrastrukturës, si dhe sqarimi i qytetarëve në sportelin përkatës në One Stop Shop.

## Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve rrit kapacitetet e shërbimeve në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz



Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve rrit kapacitetet e shërbimeve në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz. Kjo strukturë ka marrë masat e duhura për të përballuar situatat e furnizimit me ujë të pijshëm si dhe shërbimet në subjektet private dhe publike brenda territorit të Bashkisë. Ka përfunduar me sukses dhe në kohë faza e parë e projektit me KfW-në. Njëkohësisht është rritur edhe numri i abonentëve që përfitojnë nga furnizimi me ujë të pijshëm, duke përmirësuar edhe shërbimet me kanalizime të abonentëve të ndryshëm. Treguesit pozitivë të performancës së Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve ka bërë të mundur të negociohet me përfaqësuesit e KfW për fazën e dytë të implementimit të projektit të ujësjellësit si dhe të rrjeteve të KUN-ve.

Si rezultat i rritjes së performancës së ndërmarrjes, janë përmirësuar edhe treguesit financiarë, të cilat do të bëjnë të mundur për të rritur të ardhurat në buxhetin e Bashkisë dhe planifikimin e tyre për investime në sektorë strategjikë që ka Bashkia dhe shërbimet ndaj qytetarëve.

Kryebashkiaku Xhelal Mziu ka treguar rëndësinë dhe përgjegjësitë që duhet të marrin aktorët e kësaj ndërmarrjeje për të rritur shkallën e impenjimit të punonjësve të çdo sektori për të realizuar çdo objektiv që ka institucionin, për të realizuar investimet dhe shërbimet për qytetarët.

## Drejtorja e Arsimit në Bashkinë Kamëz, zgjidhje të menjëhershme problematikave në kopshtet dhe shkollat e qytetit

Drejtorja e Arsimit, Rinisë, Sportit dhe Konvikteve në Bashkinë Kamëz është një ndër drejtoritë që gjatë kësaj kohe ka pasur angazhim intensiv nga specialistët e saj në zgjidhjen e menjëhershme të çdo problematike që kanë evidentuar.

Të gjithë kanë punuar në zgjidhjen e të gjitha problematikave që janë ndeshur. Përgjithësisht, punonjësit kanë qenë shumë të gatshëm në zgjidhjen e problematikave në shkolla dhe kopshte, specifikisht me probleme elektrike dhe hidraulike, në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

Një ndër detyrat më të rëndësishme të kësaj drejtorie ka qenë edhe përditësimi i database-it të edukatorëve me të dhënat për natyrën e diplomave në lidhje me VKM-në për pagat e reja.

Sa i përket sektorit të arsimit, përveç detyrave të tjera, punonjësit kanë dalë edhe në terren, veçanërisht në kopshte, për identifikimin e problematikave të ndryshme, si dhe për të parë nga afër mbarëvajtjen e procesit mësimor-edukativ, evidentimin e numrit të nxënësve, personelit mësimor, shpërndarjes së ngarkesës mësimore brenda kompetencave dhe hapësirave që u jep ligji.

Ndër të tjera Drejtorja e Arsimit është marrë edhe me organizimin e aktiviteteve sportive dhe kulturore.



## 24 prilli si 18 shkurti, "Deja Vu" e dytë e Republikës së Re, protestë paqësore me jehonë ndërkombëtare

Nga Edmond Duraku

Dita e 65-të e protestës të opozitës së madhe e të bashkuar për zgjedhje të lira dhe të ndershme kishte metodologji ndryshe nga ditët e tjera. U shënua 18 shkurti i dytë i Republikës së Re, pasi përveçse protesta kishte karakter paqësor, si çdo ditë tjetër e kësaj proteste në "Tempullin e Lirisë" që nga dita e parë deri më sot 24orë, por bëri jehonë edhe në mediat më prestigjioze ndërkombëtare.

Kryedemokrati Lulzim Basha, pas një bashkëbisedimi vendimmarrës me aleatët e koalicionit opozitar dhe më pas me të gjithë krerët e Partisë Demokratike të degëve në gjithë Shqipërinë, arritën në përfundimin për intensifikimin e protestës në gjithë Shqipërinë. Me t'u vendosur intensifikimi i protestës, me opozitën e bashkuar, kryetari Basha në takimin e radhës të mbajtur në "Tempullin e Lirisë", na e komunikoi të gjithë të pranishmëve atë ditë që protesta jonë ndaj qeverisë së kapur nga krimi do të përshkallëzohej në ditët në vijim, nëse nuk pranojnë qeverinë teknike.

Të gjithë qëndrestarët e lirisë të pranishëm u entuziazmuan, sepse ky ishte momenti i shumëpritur nga të gjithë demokratët në të gjithë Shqipërinë për një 18 shkurt të dytë.

24 prilli shënoi një 18 shkurt të dytë, jo aq në numër, me shtrirje të gjerë në gjithë Shqipërinë, por i ngjashëm me mënyrën e të protestuarit, me sjellje të civilizuar dhe me vendosmëri deri në fitore.

Pjesëmarrje masive e qytetarëve, qëndrestarë të lirisë, protestuan në të gjitha akset kryesore të Shqipërisë në mënyrë paqësore. Ky ishte shembulli më i mirë i një proteste, pasi në asnjë nga pikat e bllokimit nuk u shënua asnjë incident, madje protestuesit tek Shkolla Teknologjikut i hapën rrugë ambulancës, pasi nuk ranë pre e



provokimeve. Sipas burimeve konfidenciale, ambulanca ishte e infiltruar, por protestuesit treguan akt qytetarie dhe e lejuan të kalonte pa hezitur fare.

Për fiks 1 orë, nga ora 11:00 -12:00 trafiku u bllokua në akset kryesore të Shqipërisë. Me "paralizimin" e trafikut shteti ra, pasi nuk funksiononte asnjë shërbim për askënd. Bllokimi i akteve kryesore ishte ide brilante e Partisë Demokratike, për të "paralizuar" funksionimin e qeverisë, në shërbimet vetjake që ajo u jep të inkriminuarve si dhe për t'i thënë qeverisë së krimin dhe fasadës se PD-ja nuk rri vetëm në çadrën e lirisë, po shtrihet edhe jashtë saj, por po pret momentin e duhur.

Mediat më prestigjioze ndërkombëtare i bënë jehonë protestës së opozitës së madhe dhe të bashkuar për zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Mediat ndërkombëtare komentuan protestën e ditës së 65-të si protestë paqësore dhe shembulli më i mirë i qytetarisë. Duke qenë se pjesa më e madhe e mediave

shqiptare janë të kapura nga Kryeministri, kësaj radhe më vjen natyrshëm pyetja se a u bënë përpjekje që protesta të mbahej e izoluar vetëm në rrafshin mediak shqiptar??? E pamundur, sepse nuk ka fuqi depërtuese mediatike që të mbajë në terr informativ mediat e huaja, pasi ata i shërbejnë opinionit publik dhe jo interesave të tyre vetjake.

"Mjeshtrit" e marrëdhënieve publike nga Kryeministria, me lupë u munduan të zhvendosnin vëmendjen e opinionit publik dhe të prodhonin "Fake News" nga protesta e 24 prillit, që ngjante me një tjetër 18 shkurt, por që mbetën në klasë, pasi nuk dinin nga ta kapnin fillin e lajmit për "Fake News" sepse protesta foli vetë.

Siç u premtua nga kryetari Lulzim Basha, asnjë lule nuk u këput, asnjë gotë nuk u thye. Merrni pak shembull si zhvillohen protestat në mbikëqyrjen e një lideri të shkolluar në Perëndim.

Në daljet mediatike, ministrat e qeverisë, që vetëm fasadën e kanë bërë mirë në këto 4 vite qeverisje, u munduan të na prodhonin

retorikë boshe politike nëpër media, sepse e morën përgjigjen e qytetarëve me protestë.

24 prilli shënohet si një 18 shkurt i dytë në Republikën e Re, pasi përveç sensibilizimit dhe qytetarisë, protesta e 24 prillit kishte mjaft benefite të tjera shumë të rëndësishme, pasi të paktën për një orë në gjithë Shqipërinë qeverisë nuk i funksionoi karteli i drogës.


Hipoteza ime është se ambulancat provokuese që kaluan në mes turmës nuk transportonin qytetarë të sëmurë, por më lind pyetja: A thua ambulancat transportonin njerëz të zënë në parcelat e hashashit, për prishje pazaresh?

Impakti ishte i jashtëzakonshëm. Fitorja ishte e qytetarëve! Fitorja ishte e tyre, pasi treguan shembullin më të civilizuar për të protestuar për të drejtat e tyre themelore, për të pasur një jetë sa më pranë standardeve. Fitorja ishte e të gjithë demokratëve të bashkuar, pasi të bashkuar më shumë se kurrë arritën në një orë të vetme të bënin mosfunksionimin e shtetit. Fitorja ishte e përbashkët e secilit prej nesh, për rezistencën tonë të pamposhtur që nga dita e parë më 18 shkurt dhe deri më tani, për zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Pra, 24 prilli si 18 shkurti, "Deja Vu" e dytë në historinë e Republikës së Re dhe Republikës së Vjetër në rënie tashmë.

Nëse edhe pas 18 shkurtit të dytë vazhdojnë me arrogancën e tyre për mosplotësimin e kushteve për zgjedhje të lira dhe të ndershme, mendoj se nevojitet një 18 shkurt i tretë, jo i paralajmëruar, për t'i dhënë shkëlmin e fundit kësaj qeverie, pasi Lulzim Basha është politikani modern që i duhet shoqërisë sonë, pasi ka koncepte dhe strategji të ndryshme në krahasim me të tjerët, në favor të interesit qytetar në lidhje me politikëbërjen në Shqipëri.

## Filloi dhuna elektorale në arsim!



Nga Artan Fuga

Më datë 22 prill, një ditë pushimi, ministrja e Arsimit dhe Sportit, zonja Lindita Nikolla, mblodhi mësuesit në Pallatin e

Kongreseve dhe paraqiti sipas saj bilancin e këtij katërvjeçari në arsim.

A mendon njeri se mund të kishte ndonjë mësues apo mësuese që mund të thoshte "nuk vij" në takimin zyrtar të organizuar nga zonja ministre? E pamundur! Takimi ku referuesi ka statusin e ministrit e bën ftesën të detyrueshme! Pra, kemi një tubim ku audienca është e detyruar të marrë pjesë.

Po të ishte ndonjë takim pune, nuk do të kishte asgjë jonormale. Por, duke dëgjuar e parë në televizion fjalimin e zonjës Nikolla, u dëshpërova, u trishtova, por nuk u zhgënjëva.

Ishte një takim elektorale i mirëfilltë. Nuk besoj se ndokush që mund të kishte ndonjë mendim të kundërt me të për çështjet dhe gjendjen e arsimit shqiptar mund ta merrte fjalën dhe ta kundërshtonte. Mësuesi në tubim të kundërshtojë ministrën?!!!

Cili ishte thelbi i fjalimit të zonjës Nikolla? Asgjë konkrete, por vetëm retorikë propagandistike dhe elektorale!

E para ajo u duk se tha që secili të votojë lirshëm në votimet e ardhshme. Por, kjo u shoqërua me mesazhin e prerë dhe kërkesën: Mos më lini vetëm në ato që kam bërë!

Thirrje e hapur elektorale drejtuar mësuesve të thirrur në një takim zyrtar me mësuesit e Shqipërisë! Votoni me mua dhe për mua!

Ja kjo është shkelje e ligjit, kjo shkakton shkatërrimin e dinjitetit të qytetarit që

thërritet me detyrim në takime të fshehura elektorale dhe të maskuara keq e shumë keq!

Zonja Nikolla nuk mungoi sikurse ka bërë këto katër vjet që të hedhë nga tribunat zyrtare edhe fyerje edhe ofendime ndaj kritikuesve të gjendjes ku ndodhet arsimit shqiptar sot, dhe për të cilën nuk është se e ka përgjegjësinë e parë dhe të vetme. Unë jam nga këta kritikë dhe u ndjeva i sulmuar nga një zyrtare e lartë e shtetit!

Arsimi shqiptar ka njëzet vite që lëngon dhe këto katër vite e kanë përkeqësuar edhe më shumë gjendjen e tij.

Ministrja ka përgjegjësitë e veta!

Nuk dëgjuam një gjë që nuk është bërë mirë, por vetëm vetëlavdërime dhe suksese, kur gjendja e arsimit shqiptar dhe edukimi i të rinjve është e mjeruar.

Pretendoj se kemi një arsim të standardeve evropiane për moshat nga tre deri në pesëmbëdhjetë e kusur vjeç. Unë nuk dua të besoj se zonja Nikolla gënjen, por atë ose e gënjejnë, ose bashkëpunëtorët e saj nuk ia kanë haberin fare se çfarë është sot arsimit parauniversitar në Evropë.

Nëse do ta dijë se si dalin nxënësit nga ky arsim të vijë t'ia dëftojmë edhe ne në mënyrë po aq të përvuajtur sa edhe fjala e saj, po aq të prekur, por po aq me besimin se gjërat mund të ndreqen shumë shpejt nëse ka vullnet politik.

U përpoq që duke i bërë thirrje armatës

së mësuesve të mos e lënë vetëm atë, ta bëjë këtë armatë mësuesish përgjegjëse dhe bashkëpërgjegjëse me politikat në fuqi prej dekadash dhe të aplikuar edhe prej saj që e kanë shkatërruar shkollën shqiptare.

Të rinjtë, mësuesit, prindërit nuk meritojnë dhunë elektorale, propagandë të fshehur duke u thirrur audienca me detyrim, retorikë boshe dhe lustrim të një gjendje që të gjithë me përjashtim të bashkëpunëtorëve të zonjës Nikolla e dinë që është për t'u vajtuar. Dhe për këtë nuk e kanë fajin mësuesit, ata janë si nxënësit viktimë të politikës.

Shembulli i sotëm në këtë krizë politike që ka mbërthyer vendin e që ka vendosur në dyshim mundësinë e zgjedhjeve të lira, provon në mënyrë krejt paradoksale se ja sesi abuzohet me pushtetin për të ushtruar dhunë elektorale mbi nxënësit, mësuesit, prindërit, duke inskenuar maskarada elektorale pa dobi shoqërore dhe madje edhe pa dobi elektorale.

Le ta kalojë edhe një herë ligjin për arsimin e lartë në Kuvend dhe do të shohë se veç opozitës nuk do ta votojë më as LSI, as Libra, duke rrezikuar siç është shpallur publikisht të mbetet në pakicë.

Kurse, po të duhet të dalin parametrat e vërtetë të gjendjes të arsimit parauniversitar, le të hapet debati mbarëpopullor, sikurse fushata elektorale do ta ketë rastin ta bëjë gjerësisht, thellësisht.



# Federata Shqiptare e Basketbollit nderon me “Certifikatë Mirënjohjeje” kryebashkiakun Xhelal Mziu

## Vlerësimi, për kontributin e dhënë në zhvillimin e basketbollit në qytetin e Kamzës

Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, është nderuar nga Federata Shqiptare e Basketbollit me “Certifikatë Mirënjohjeje” për kontributin e dhënë në zhvillimin e basketbollit në qytetin e Kamzës. Certifikata iu dorëzua kryebashkiakut Mziu në kuadër të 70-vjetorit të FSHB-së nga sekretari i përgjithshëm i kësaj Federate, z. Korab Llazani, në një takim që u zhvillua në zyrën e kreut të Bashkisë. Bashkë me certifikatën z. Llazani i dhuroi kryebashkiakut Mziu edhe simbolin e 70-vjetorit të FSHB-së si dhe një album përgatitur për këtë vit jubilar, në të cilin Kamza ka një vend të rëndësishëm.

“Jam i emocionuar, - u shpreh z. Mziu, - sepse qyteti i Kamzës më në fund arriti që të ishte pjesë e sportit. Unë uroj 70-vjetorin e Federatës, por një përgëzim maksimal për presidentin, sekretarin e përgjithshëm dhe gjithë stafin drejtues. Unë ndihem shumë i kënaqur për basketbollin, për të cilin dua të vlerësoj maksimalisht trajnerin Adem Muhametaj, si banor i Kamzës, por edhe si një person që këmbënguli që Kamza duhet të përfaqësohet në basketboll. Sporti i basketbollit mbetet një sport, në radhë të parë, që ndikon pozitivisht tek qyteti, tek të rinjtë kryesisht, dhe ia ka arritur qëllimit, ndaj jam shumë i kënaqur, sepse kanë filluar tashmë me ekipet zinxhir, kurse në çdo shkollë orientohen drejt basketbollit dhe është për ta një sport shumë i mirë”. Duke folur për sportin e basketbollit dhe rolin që luan ai sidomos te të rinjtë, kreu i Bashkisë Kamëz



tha: “Realisht unë e konsideroj basketbollin si një instrument, i cili e ka bërë të njohur qytetin e Kamzës, duke hedhur një hap shumë të rëndësishëm për sportin në përgjithësi dhe veçanërisht për basketbollin, kështu që vërtet ndihem shumë i gëzuar që edhe Kamza përfaqësohet në basketboll, bëhet pjesë e festimeve apo e biografisë së këtyre 70 viteve, kështu që unë ju falënderoj dhe ju uroj përzemërsisht!”

Gjatë takimit, z. Mziu bëri të ditur angazhimin e tij edhe në të ardhmen për sportin e basketbollit. “Shpreh angazhimin tim

maksimal për të qenë pjesë kontribuuese e basketbollit, duke shfrytëzuar çdo lloj mundësie për t’i krijuar infrastrukturë, për të nxitur grupet e ndryshme, edhe të rejtat, edhe të rinjtë, për të qenë pjesë e këtij sporti. Ajo çfarë është themeloria, për ta bërë një sport popullor për qytetin”, - u shpreh z. Mziu.

Sekretari i përgjithshëm i FSHB-së, Korab Llazani, mes të tjerave tha se Kamza ka një vend të merituar në këtë 70-vjetor të Federatës Shqiptare të Basketbollit. Në emër të presidentit të Federatës dhe të tijin, z. Llazani shprehu mirënjohjen për kreun e Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu. “Mbështetja nuk ka munguar, ashtu siç bashkëpunimi nga këtu ka qenë shumë frytdhënës”, - u shpreh ndër të tjera z. Llazani, duke theksuar se sistemi i ekipeve zinxhir po funksionon dhe ka për të mbushur ekipet e Kamza Basket dhe premtion për të ardhmen. “Jeni duke bërë punën më të mrekullueshme, është puna më e mirë. Fakti që është duke u rritur numri i atyre që shkojnë drejt basketbollit, edhe nga shkollat, është një tregues pozitiv i jashtëzakonshëm”, - pohoi sekretari i përgjithshëm i FSHB-së.

Një pikë e rëndësishme e takimit ishte edhe projekti i pallatit të sportit në qytetin e Kamzës dhe ndërtimi sa më parë i tij. Kryebashkiaku Mziu tha se ndërtimi i pallatit të sportit do të ishte një zgjidhje jo vetëm për Kamzën, por edhe gjithë Shqipërinë, pasi projekti ka parametra bashkëkohore, i hartuar nga një prej studiove më të mira në vend.

## Presidenti Bujar Nishani dekoron trajnerin e Kamza Basket, Adem Muhametaj, me titullin “Mjeshtër i Madh”

Muhametaj pas titullit: Xhelal Mziu, mbështetësi kryesor i ideve dhe projekteve të mia për ngritjen, zhvillimin dhe arritjen e niveleve më të larta të basketbollit nga ekipet e qytetit tonë Kamza në nivel kombëtar



Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Bujar Nishani, ka dekoruar trajnerin e Kamzës në basketboll, z. Adem Muhametaj, me titullin “Mjeshtër i Madh”, me motivacionin “Në vlerësim të kontributit të dhënë ndër vite për lartësimin dhe rritjen cilësore të sportit të basketbollit, përmes një pune të palodhur dhe arritjes së rezultateve të niveleve të larta kombëtare dhe ndërkombëtare, duke entuziazmuar sportdashësit shqiptarë”.

Çmimi i madh, trajnerit të suksesshëm të Kamzës në basketboll për meshkuj iu akordua në mbrëmjen jubilarë me rastin e 70-vjetorit të themelimit të Federatës Shqiptare të Basketbollit.

Në ceremoninë gala të organizuar në Pallatin e Kongreseve, ishte i pranishëm edhe Presidenti i Republikës, z. Bujar Nishani, presidenti i FIBA EUROPE, z. Turgai Demirel, si edhe shumë personalitete dhe figura të nderuara të “koshit”, por edhe sportistë që janë në aktivitet të vazhdueshëm me sportin e basketbollit.

Trajneri Muhametaj pas çmimit është shprehur se i është shumë mirënjohës veçanërisht kryebashkiakut të Kamzës, pasi ka qenë mbështetësi kryesor në zhvillimin e basketbollit në Kamëz dhe më gjerë: “Ndihem shumë i privilegjuar për këtë vlerësim të punës sime në rrugën e gjatë të zhvillimit të basketbollit. Dua të falënderoj të gjithë bashkëpunëtorët e mi që më kanë ndihmuar pa masë në arritjen e këtyre rezultateve. Falënderoj të gjithë sportistët që kanë qenë dhe janë me mua në lartësimin e sportit të basketbollit.

Falënderoj përzemërsisht Presidentin e Republikës, z. Bujar Nishani, dhe Federatën Shqiptare të Basketbollit për këtë titull “Mjeshtër i Madh”.

Falënderim i veçantë për kryetarin e Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, i cili ka qenë vazhdimisht mbështetësi kryesor i ideve dhe projekteve të mia për ngritjen, zhvillimin dhe arritjen e niveleve më të larta të basketbollit nga ekipet e qytetit tonë Kamza në nivel kombëtar”.

## “Kamza Karate Open 2017”, turneu ndërkombëtar në palestrën e Bathores me pjesëmarrjen e sportistëve nga 5 shtete

Kryebashkiaku Mziu: “Le të shërbejë ky aktivitet ndërkombëtar i zhvilluar në Kamëz edhe për promovimin e qytetit të Kamzës, jo veç si aktivitet sportiv, por edhe bashkimin midis shteteve”.

“Le të shërbejë ky aktivitet ndërkombëtar i zhvilluar në Kamëz edhe për promovimin e qytetit të Kamzës, jo veç si aktivitet sportiv, por edhe bashkimin midis shteteve”. Kështu është shprehur kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, gjatë fjalës që mbajti në turneun ndërkombëtar “Kamza Karate Open 2017”, i cili u zhvillua në palestrën e Bathores më datë 30 prill. Ky është turneu i tretë ndërkombëtar “Kamza Karate Open”, i cili është bërë traditë për qytetin e Kamzës. Ndër të tjera në fjalën e tij përshëndetëse kreu i Bashkisë Kamëz, z. Mziu, u shpreh: “Ju uroj mirëseardhjen në qytetin e Kamzës! Dua të falënderoj presidentin e Federatës së Shqipërisë, presidentin e Federatës së Kosovës dhe përfaqësuesin e Ulqinit, por edhe të gjitha ekipet pjesëmarrëse të Shqipërisë, të Kosovës, të Malit të Zi, të Maqedonisë dhe të Greqisë”. Përveç urimit të mësipërm, z. Mziu vlerësoi këtë aktivitet sportiv edhe në kuadrin e bashkëpunimit midis shteteve. “Unë ju uroj suksese dhe fitoftë më i miri! Le të shërbejë ky aktivitet ndërkombëtar i zhvilluar në Kamëz edhe për promovimin e qytetit të Kamzës, jo veç si aktivitet sportiv, por edhe bashkimin midis shteteve!”, - u shpreh kryebashkiaku Xhelal Mziu në fjalën e tij përshëndetëse. “Falënderojmë të gjithë pjesëmarrësit që morën pjesë në këtë eveniment si dhe Bashkinë Kamëz dhe personalisht z. Xhelal Mziu për angazhimin dhe mbështetjen që jep vazhdimisht në organizimin e këtij kampionati kaq madhështor”, - është shprehur trajneri i ekipit Kamza Karate, z. Luftar Kurti, që është ndër organizatorët e turneut ndërkombëtar “Kamza Karate Open”. Ky aktivitet madhështor, si në numrin e pjesëmarrjes ashtu dhe në nivelin sportiv, cilësor dhe organizativ tashmë është bërë traditë për qytetin e Kamzës. Kampionati i tretë u organizua nga Bashkia Kamëz në bashkëpunim me shoqatën sportive “Kamza Karate” dhe Federatën Shqiptare të Karatesë. Nismëtar kryesor për organizimin e këtij aktiviteti madhështor për të 3-in vit radhazi ishte trajneri i Kamzës, Luftar Kurti, me mbështetjen e Bashkisë



dhe personalisht të kryebashkiakut Xhelal Mziu. Këtë vit u vërtetua se falë organizimit të mirë dhe cilësor u rrit numri i pjesëmarrësve dhe sportdashësve në mbi 1500 vetë ditën e zhvillimit të aktivitetit. Në këtë eveniment morën pjesë 470 sportistë në dy disiplinat kumite (ndeshje) dhe kata (ushtrime të lira), nga 5 shtete të ndryshme, si: Kosova, Greqia, Mali i Zi, Maqedonia dhe Shqipëria, nga këto 41 klube. Kamza u përfaqësua me 31 sportistë nga të gjitha grupmoshat dhe mori gjithsej 7 medalje ari, 5 argjendi dhe 11 bronzi. Nga këto: me medalje ari u stolisën Ernik Pjetri, Elton Kadriu, Danjoll Mehmetaj, Mariglana Spahiu, Aurel Pulaj, Leonard Shota; me medalje argjendi Edilson Loci, Ervin Kadriu, Lion Zmali, Bledar Daci, Iliana Kurti; me medalje bronzi Xhani Nikolli, Valentino Tanushi, Oresti Kurti, Aurel Pulaj, Ernik Pjetri, Rigers Boci, Orgito Koci Anxhelson Hysa, Klevis Buci, Adriano Korbi dhe Roberto Maklekaj. U shpërndanë pllaketa mirënjohjeje dhe kupa për klubin më të suksesshëm, klubin me masovik dhe për sportistët më të mirë të aktivitetit si dhe kupë për dy klubet më të suksesshme. Në përfundim të aktivitetit në bazë të rezultateve përfundimtare në rang shtetesh pjesëmarrëse në këtë eveniment kupën si federata më e suksesshme e mori Federata e Karatesë së Kosovës.

Kupën si ekipi më i suksesshëm e fitoi ekipi Kamza Karate. Kupën e ekipit më masovik e mori “Bijtë e Shqipës” nga qyteti i Lushnjës. Me kupën si sportisti më i suksesshëm në senior u nderua Spajdi Celami, ndërsa kupën si sportistja më e suksesshme në senjore e fitoi Borbardha Sulaj. Ky aktivitet u organizua me standarde evropiane dhe përfundoi me sukses, pa lëndime.